



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.06.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.06.2024, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik **N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i Rrugës X**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511, **nxjerr:**

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve ekonomik **N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K.**, e dt.**07.06.2024**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i Rrugës X**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 03.06.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **03.06.2024;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

**A r s y e t i m**

Grupi i Operatorëve ekonomik **N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K.**, me dt.**07.06.2024**, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e

prokurimit "Ndërtimi i Rrugës X", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.06.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Ju si Grupi i Operatorëve ekonomik **N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K.** keni prezantuar Listën e punëtorëve nga kompania "Eskavatori" është listë e dedikuar për projektin me titull: "Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë – Pjese e qarkores se qytetit", me nr. të prokurimit: 632-23-636-5-1-1 dhe si e tillë nuk vlen për këtë aktivitet të prokurimit, pra kjo listë nuk është siç është kërkuar me FDT dhe OE është administrativisht i pa përgjegjshëm. *Referuar edhe vendimit të OSHP me nr. OSHP: 2023/0560 i dt.08.12.2023, faqe 8 ku GOE i rekomanduar për kontratë ishte shpallur i pa përgjegjshëm për shkak të titullit të kontratës për kontratën e kamionëve*, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron;

Te ky grup i OE, ne baze te dokumenteve të dorëzuara për stafin profesional si Vendimet, CV, diplomat dhe kontratat e punës janë gjetur këto mangësi:

Pretendimi juaj Udhëheqësit ne punishte ne projektet e ndërtimit, rehabilitimit apo ri-konstruktimit te rrugëve Besnik Zogu, nuk ka mundur t'i ngarkohet certifikata për menaxhim dhe organizim të kantierit për shkak të megabaitve të fail-it, nuk qëndron sepse ju keni mundur që dokumentacionin ta ndani në disa faile.

Për Inxhinierin e Elektrikes Kristë Duzhmani, nuk ju janë kërkuar **sqarime shtesë konform nenit 72 , sepse këto dokumente nuk mundte te vërtetohen nëse ekzistenca e tyre është para datës se dorëzimi te tenderëve dhe nuk mundte te verifikohet nëse kane ekzistuar para datës se dorëzimit te ofertave.**

Ju keni bashkangjitur 54 certifikata të SSHP (Siguria dhe shëndeti në punë), të cilat janë për punëtorët e liderit "Eskavatori", mirëpo lista e punëtorëve nga kompania "Eskavatori" është listë e dedikuar për projektin me titull: "Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë – Pjese e qarkores se qytetit", me nr. të prokurimit: 632-23-636-5-1-1 dhe si e tillë nuk vlen për këtë aktivitet të prokurimit, pra kjo listë nuk është siç është kërkuar me FDT dhe OE është administrativisht i pa përgjegjshëm, prandaj edhe pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron, sepse ju jeni eliminuar se lista e punëtorëve nga kompania "Eskavatori" është listë e dedikuar për projekt tjetër;

Autoriteti kontraktues në FDT-ë ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet te ketë vlerësimin e riskut për te gjitha pozitat e punës nga një kompani e licencuar prej MPMS dhe te dëshmohet me raport te noterizuar. Nga lideri "Eskavatori" është dorëzuar raporti i vlerësimit të riskut për te gjitha pozitat e punës e përpiluar nga kompania "Trend CMSH" (e licencuar për SSHP), mirëpo ky raport nuk është dorëzuar i noterizuar siç është kërkuar në DT, është dorëzuar i noterizuar një vërtetim i lëshuar nga "Trend CMSH" i cili nuk është kërkuar në DT, pra

kërkesa ka qenë që raporti i vlerësimit të riskut të jetë i noterizuar dhe OE nuk ju ka përmbajtur kësaj kërkesë të FDT-së, prandaj edhe ky pretendim i juaj nuk qëndron .


Pretendimi juaj lidhur me Shpresa Haziri, është i bazuar, po kjo nuk ndryshon vendimin e Autoritetit kontraktues, sepse ju nuk plotësoni kërkesat e lartpërmendura në FDT-ë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

**Faton Gutaj**

  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;